

URDHËR
Nr. 13, datë 16.1.2023

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS SË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË MINISTRISË
PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME NË PROCESET GJYQËSORE**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të RSH-së”, ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, nenet e 22 e vijues të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për përfaqësimin ligjor të institucionit në proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjyqimit dhe në Gjykatën Kushtetuese.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në proceset gjyqësore të lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm në emër të personit apo personave që do të përfaqësojnë institucionin.

3. Përfaqësuesi i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural të parashikuar nga legjislacioni në fuqi përpara gjykatave, prokurorisë, zyrave të përmbarimit gjyqësor, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.

4. Të gjitha aktet e nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij urdhri dhe që janë nxjerrë në zbatim të urdhrit nr. 30, datë 15.2.2022, “Për delegim kompetencash”, pika “a” e urdhrit të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në përfundimin e procesit gjyqësor përkatës.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

6. Urdhri nr. 30, datë 15.2.2022, “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT
E JASHTME
Olta Xhaçka**